



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNAL.AL ♦ Numri 3

Shtator 2017

SHTYLLA III TË DREJTAT E NJERIUT

Abuzimi seksual i fëmijëve, mbrojtja ndërkombëtare dhe sistemi ligjor shqiptar

Nga Elona Hasko dhe Av. Holta Ymeri

I. ABSTRAKT

Ky artikull trajton një shkelje shumë serioze të të drejtave të njeriut, abuzimin seksual, të kryer kundër një kategorie të veçantë dhe të pambrojtur të shoqërisë tonë: fëmijët. Artikulli synon të trajtojë në mënyrë gjithëpërfshirëse fenomenin e abuzimit seksual të fëmijëve dhe pasojat e tij, si dhe masat e marra për ta parandaluar atë në nivel ndërkombëtar dhe në rendin juridik shqiptar. Kështu, paragrafi II ofron një përmbledhje të fenomenit, të dhënat e mbledhura dhe ekspertizën e psikologut në lidhje me pasojat e abuzimit seksual. Paragrafët e tjerë japin analizën e detajuar të masave ligjore dhe administrative të marra në nivel ndërkombëtar dhe shqiptar. Konkretisht, paragrafi III trajton dokumentet ndërkombëtare ekzistuese të cilat rregullojnë çështjen e abuzimit seksual të fëmijëve, ndërsa paragrafi IV ofron një përmbledhje të kornizës ligjore dhe institucionale shqiptare. Konkluzionet dhe rekomandimet e zhvilluara në paragrafin V ofrojnë analizën krahasuese të legjislacionit shqiptar me legjislacionin ndërkombëtar dhe përmbajnë rekomandime të posaçme për ndryshime ligjore.

FJALËT KYÇE: fëmijë; abuzim seksual; Konventa e Lanzarotë-s; KEDNJ; mbrojtje; BE; Legjislacioni shqiptar.

SHKURTIME:

BE	Bashkimi Europian
DUDNJ	Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
GJEDNJ	Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut
KDF	Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve
KDPM	Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur
KE	Këshilli i Europës
KEDNJ	Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut
KKMDF	Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës
Konventa e Lanzarotë-s	Konventa e Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual
KP	Kodi Penal
KPrP	Kodi i Procedurës Penale
Ligj nr. 18/2017	Ligj nr. 18, datë 23.02.2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”
TBE	Traktati i Bashkimit Europian

II. ABUZIMI SEKSUAL I FËMIJËVE, SHTRIRJA DHE PASOJAT E TIJ

Sipas Këshillit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (1999): *“Abuzimi seksual i fëmijëve është përfshirja e një fëmije në një aktivitet seksual për të cilin fëmija nuk është i përgatitur fizikisht, të cilin fëmija nuk e kupton plotësisht, është i/e paafte të japë miratimin, ose që shkel ligjet apo tabutë sociale të shoqërisë . Abuzimi seksual i fëmijëve ndodh nga veprimi mes një fëmije dhe një të rrituri/apo një fëmije tjetër që ka moshë apo zhvillim të përgjegjshëm, veprim ky i qëllimshëm për të plotësuar dhe kënaqur nevojat e personit tjetër apo fëmijës tjetër. Kjo mund të përfshijë (por nuk është e kufizuar): nxitje apo detyrim i fëmijës për t’u përfshirë në ndonjë veprim seksual të paligjshëm; shfrytëzimi i fëmijës për prostitucion apo ushtrime të tjera të paligjshme; shfrytëzimi i fëmijëve për shfaqje apo materiale pornografike.”¹*

Përfshirja e fëmijëve në një aktivitet seksual mund të vijë përmes detyrimit/dhunës ose joshjes (dhënies së dhuratave, parave, kujdesit të veçantë ndaj fëmijëve). Abuzimi seksual, shpesh, përfshin kontaktin e drejtpërdrejtë fizik, prekjen, puthjet, përkëdheljet, fërkimin, seksin oral, ose penetrimin vaginal apo anal ose detyrimin e fëmijës të prekë organet gjenitale të abuzuesit. Ndonjëherë abuzuesi seksual mund të arrijë kënaqësi edhe thjesht duke e ekspozuar veten përpara një fëmije ose duke vëzhguar atë në tualet ose duke filmuar një fëmijë që heq rrobat e tij/të saj. Shpeshherë, abuzuesit nuk përdorin forcë fizike, por mund të përdorin lojën, kërcënimet, lajkat ose metoda të tjera që bindin dhe angazhojnë të vegjlit të mos iu tregojnë të rriturve për abuzimin. Ngacmimi/abuzimi seksual përfshin dhe kontaktin jo të drejtpërdrejtë si p.sh. telefonatat/shkrimet e pahijshme me përmbajtje seksuale në kompjuter apo me shkrim dore, pyetjet apo komentet seksuale, seksin virtual apo ngacmimet seksuale online, tregimin e fotove të pahijshme ku ka fëmijë apo të rritur të zhveshur. Shfrytëzimi seksual i fëmijëve kundrejt parave, është gjithashtu abuzim seksual.

Fenomeni i abuzimit seksual të fëmijëve është një fenomen global, shtrirja e të cilit nuk dihet me saktësi për shkak të vështirësisë që kanë fëmijët të raportojnë dhe të denoncojnë abuzimin e pësuar. E njëjta vështirësi haset edhe në Shqipëri, ku mungojnë statistika të mirëfillta zyrtare dhe ku të dhënat, shpesh mbledhen nga studimet dhe raportimet e organizatave joqeveritare me objekt mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve apo nga raportime sporadike dhe të kufizuara të institucioneve shtetërore që vendosen në kontakt me këtë fenomen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Megjithatë mungon një bazë të kombëtare dhënash të koordinuara, e cila të mbledhë dhe të përpunojë të dhënat për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Më poshtë, jepen të dhënat e mbledhura nga studime dhe raportime ekzistuese ndër vite:

- i. Sipas një studimi nga Qendra e Trajtimin Multidisplinor për Problemet e Keqtrajtimin të Fëmijëve (2003) që përfshiu fëmijët e moshave 6-12 vjeç dhe 13-18 vjeç, 11% e tyre kishin pësuar ngacmime seksuale dhe 4% e tyre i kishin përjetuar ato në mjedisin

¹1999 WHO Consultation on Child Abuse Prevention,
http://www.who.int/violence_injury_prevention/resources/publications/en/guidelines_chap7.pdf

- familjar. Në tërësi, 4% e fëmijëve të përfshirë në këtë studim pranuan përjetimin e dhunës seksuale².
- ii. Në një tjetër studim të vitit 2006, “*Dhuna ndaj fëmijëve në Shqipëri*”, i mbështetur nga UNICEF lidhur me abuzimin seksual, përveç rasteve të fenomenit të përdhunimit nga persona të panjohur, u konstatuan edhe raste të abuzimit seksual brenda rrethit të besimit të fëmijëve. Subjektet e studiuara raportuan se 13.3% e tyre ngacmoheshin seksualisht. Sipas këtij studimi, shkolla është një mjedis ku mund të ndodhë abuzimi seksual. Po kështu, sipas këtij studimi, një në pesë ngacmues seksualë të fëmijëve (22.5%) ishte mësues. Tërheq vëmendjen fakti që ngacmimi seksual i raportuar nga fëmijët në sistemin e përkujdesjes shoqërore (prej 15%), ishte më i lartë se në mjedise të tjera. Në këtë studim, fëmijët e sistemit të përkujdesjes shoqërore raportuan autorësinë e ngacmimeve seksuale si vijon: 55.6% nga fëmijët e tjerë, 22.2% nga mësuesit dhe 22.3% nga persona të tjerë³.
 - iii. Studimi mbi “*Prevalencën e Përvojave Negative gjatë Fëmijërisë*” i realizuar në Shqipëri në vitin 2012, ofron të dhëna mbi abuzimin seksual gjatë fëmijërisë të rinjve shqiptarë. Kështu, nga 1437 studentë të pyetur mbi eksperiencat negative gjatë fëmijërisë (gjatë 18 viteve të para të jetës), 6% e tyre raportuan se ishin abuzuar seksualisht gjatë kësaj periudhe. Djemtë raportuan më shumë abuzim seksual në krahasim me vajzat gjatë periudhës së fëmijërisë së tyre 8.8% kundrejt 4.7%, përkatësisht.
 - iv. Ndërsa, sipas një studimi mbi profilin e fëmijëve shqiptarë të dhunuar bazuar në raste të raportuara, të realizuar nga Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA) rezulton se 23% (28 raste nga 120 të raportuara) e fëmijëve kishin pësuar dhunë seksuale. Nga ky studim u gjet se, 75% e fëmijëve të abuzuar seksualisht janë të gjinisë femërore⁴.
 - v. Gjithashtu, nga institucione që kanë raportuar vitet e fundit mbi rastet e të gjitha llojeve të abuzimit të fëmijëve, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në Tiranë raportoi numrin më të madh të rasteve të abuzimit të fëmijëve (790 raste). Për sa i takon rasteve të abuzimit seksual ndaj fëmijëve, sërish numri më i madh i rasteve u raportua nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në Tiranë, e cila për vitin 2014-2015 regjistroi 46 raste të tilla. Për sa i takon ndëshkimit të autorëve të abuzimit seksual ndaj fëmijëve, vetëm Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në Tiranë raportoi se në 54% të rasteve (25 nga 46 raste të abuzimit seksual ndaj fëmijëve) ishin marrë masa ndëshkimore të rënda ndaj dhunuesve.
 - vi. Qendra Psiko-Sociale “Vatra” në Vlorë raportoi një numër prej 24 rastesh të abuzimit seksual ndaj fëmijëve, për periudhën 2014-2015⁵.
 - vii. ARSIS raportoi 13 raste të të abuzimit seksual ndaj fëmijëve për periudhën 2014-2015⁶.

² Referuar në botimin e Terre des hommes (2015) “Abuzimi seksual i fëmijëve në rrethin e besimit në Shqipëri : Një studim cilësor mbi perspektivat dhe perceptimet e profesionistëve, prindërve dhe fëmijëve », fq.17.

³ Ibid

⁴ Hazizaj, A., Coku, B., Cenko, E., Haxhiymeri, E., Case-based surveillance study on violence against children in Albania, CRCA Albania, Tirana 2013.

⁵ Referuar në botimin e Terre des hommes (2015) “Abuzimi seksual i fëmijëve në rrethin e besimit në Shqipëri : Një studim cilësor mbi perspektivat dhe perceptimet e profesionistëve, prindërve dhe fëmijëve”, fq.21-22.

⁶ Ibid, fq.22.



Por cilat janë pasojat e ngacimit/abuzimit seksual tek fëmijët dhe adoleshentët?

Tek fëmijët e mitur, të moshës parashkollore, mund të dallohen lojëra traumatike në të cilat fëmijët aktrojnë apo riaktivizojnë disa aspekte të përvojës traumatike. Përshembull një fëmijë mund të luajë në mënyrë të përsëritur një lojë sikur do t'i shpëtojë apo do të largohet nga "njeriu i keq". Mund të dallohen shenja të tjera të stresit, një rritje e sjelljeve kundërshtuese ose refuzuese, rritje e shpërthimeve të inatit dhe maktheve gjatë natës. Fëmija mund të angazhohet në sjellje të papërshtatshme seksuale për moshën që ka si p.sh. të angazhojë një fëmijë tjetër në kontakte orale-gjenitale ose të stimulojë interkurse. Fëmija mund të thotë se trupi i vet është "lënduar" ose është "i pisët".⁷

Përsa i përket pasojave tek adoleshentët, simptomat bazë të stresit post-traumatik janë të njëjta, por teksa fëmijët rriten dhe zhvillohen në mënyrë më autonome, vështirësitë që ndeshin adoleshentët mund të jenë më serioze. Ata kanë akses më të madh tek substancat narkotike, kështu që për t'u përballur me hipervigilencën dhe ripërjetimin e simptomave traumatike, ata do të jenë më të gatshëm dhe më të dëshiruar për të abuzuar me substanca narkotike. Një adoleshent i shmang kujtimet traumatike duke u tërhequr nga jeta shoqërore. Dëmtimi i vetes me prerje të lëkurës apo në trup dhe sjelljet vetvrasëse janë, gjithashtu, më të zakonshme tek adoleshentët se sa tek fëmijët.⁸

Kërkimet e shumta kanë evidentuar probleme të shëndetit mendor, probleme që përfshijnë frikën, ankthin, shtypjen të stresit post-traumatik, depresion, vështirësi seksuale, vetëvlerësim të dobët, stigmatizim, vështirësi për t'iu besuar të tjerëve, shtrembërime konjitive, vështirësi me sjelljet prosociale, agresivitet, sjellje të papërshtatshme, deficite në marrëdhëniet bashkëmoshatare dhe probleme të tjera.⁹ Nëse këto shqetësime mbeten të patrajtuara nga stafet profesionale të shëndetit mendor dhe social, pasojat, për fëmijët dhe adoleshentët e abuzuar, do të zgjasnin në kohë.

III. ABUZIMI SEKSUAL I FËMIJËVE SIPAS LEGJISLACIONIT NDËRKOMBËTAR

Gjatë dekadave të fundit, vihet re një rritje e vëmendjes ndaj të drejtave të fëmijëve provë e së cilës janë miratimi i një sërë konventash ndërkombëtare që përcaktojnë parimet dhe standardet që duhet të ndjekin dhe respektojnë Shtetet, kur trajtojnë atë kategori të pambrojtur të shoqërisë të quajtur fëmijë. Dokumenti i parë ndërkombëtar që njohu rëndësinë e statusit të fëmijës është Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ) e shpallur në vitin 1948¹⁰, e cila në nenin 25 (2) parashikon se: "*nënat dhe fëmijët kanë të drejtën për kujdes dhe ndihmë të posaçme*". Që atëherë, numri i dokumenteve ndërkombëtare që trajtojnë të drejtat e fëmijëve dhe përcaktojnë standardet dhe parimet që mbrojnë këto të drejta, ka qenë në rritje.

⁷ "Questions and answers about sexual abuse: An interview with Esther Deblinger, PH.D.", The National Traumatic Stress Child Network. http://www.nctsn.org/sites/default/files/assets/pdfs/ChildSexualAbuse_QA.pdf.

⁸ Ibid

⁹ Johnson, L. Sharon, (2004) "Therapist's Guide to Clinical Intervention" Academic Press, Elsevier Science.

¹⁰ Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ), ratifikuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara e Paris datës 10 Dhjetor 1948, nëpërmjet Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme 217.

Është e rëndësishme të përmendet se mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të fëmijëve parashikohet nëpërmjet një sërë instrumentesh ligjore ndërkombëtare të tilla si: konventat¹¹; politikat soft-law¹² dhe rekomandimet; vendimet dhe rregulloret e detyrueshme¹³, vendimet e gjykatave¹⁴; komitetet¹⁵. Konventat ndërkombëtare, mund të kategorizohen si më poshtë: (i) konventa të përgjithshme ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që përfshijnë dispozita të posaçme për të drejtat e fëmijëve¹⁶; (ii) konventa të përgjithshme ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të cilat në mënyrë indirekte mbrojnë të drejtat e fëmijëve¹⁷; (iii) konventa të posaçme ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Paragrafët e mëposhtëm ofrojnë një përmbledhje të konventave më të rëndësishme ndërkombëtare dhe instrumenteve detyruese që kanë një ndikim të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në përgjithësi dhe në mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi seksual në veçanti.

3.1. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës (KDF)

Konventa e parë ndërkombëtare kushtuar mbrojtjes së posaçme të të drejtave të fëmijëve është Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve (KDF), e cila është miratuar në vitin 1989 dhe ka hyrë në fuqi në vitin 1990. Kjo konventë përcakton dhe parashikon një grup të rëndësishëm parimesh dhe standardesh ligjore mbi të drejtat e fëmijëve. Ajo fillon duke përkufizuar në Nenin 1 se “*me fëmijë kuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç*” përveç rastit kur legjislacioni i shteteve anëtare parashikon se “*mosha madhore arrihet më përpara*”. Në pjesën e parë të saj të përbërë nga 41 Nene, KDF-ja shtrin tek fëmijët të drejtat e përgjithshme të njeriut duke i përshtatur ato me kushtet e veçanta të fëmijës. E veçanta e KDF-së është se që në fillim të saj vendos një parim udhëzues i cili duhet të zbatohet gjithmonë në trajtimin e atyre situatave që kanë ndikim tek fëmijët, parimi “*interesi më i lartë i fëmijës*”¹⁸. Ideja në themel të këtij parimi është se të gjitha veprimet që ndikojnë te fëmijët, qoftë këto të ushtruara nga ente dhe institucione publike apo private, duhet t’i japin prioritet interesit më të mirë të fëmijës, që do të thotë se kur është e nevojshme të peshohen të drejtat/ interesat e subjekteve të tjera (për shembull prindërit e fëmijëve) dhe të drejtat e fëmijëve, këto të fundit duhet të mbizotërojnë në çdo vendimmarrje që kanë impakt mbi to. Të drejta të tjera të

¹¹ Për shembull Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve (KDF), miratuar nga rezoluta 44/25 e datës 20 Nëntor 1959 e Asamblesë së Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara.

¹² Termi soft-law i referohet atyre akteve të shkruara si politika, dokumente parimesh, rregullore, udhëzime, rekomandime të cilat nuk kanë në vetvete fuqinë e ligjit dhe nuk janë drejtpërdrejtë të zbatueshme. Vlera e tyre është e rëndësishme në kuadër të interpretimit të parimeve dhe akteve të ndryshme në mbështetje të të cilave aktet e soft-law lëshohen. P.sh: Strategjia e Këshillit të Europës për të Drejtat e Fëmijës, 2016-2020

¹³ DIREKTIVA e BE-së 2011/92/EU.

¹⁴ Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

¹⁵ Komiteti i Palëve në Konventën për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual, (Komiteti i Lanzarote-s): www.coe.int/en/web/cjildren/lanzarote-convention

¹⁶ Siç është rasti i Nenit 10 i i Plaktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore – PNEŠK, miratuar nga Rezoluta 2200 A (XXI) e datës 16 Dhjetor 1966 e Asamblesë së Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara tw datws .

¹⁷ Siç është rasti i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

¹⁸ Neni 3 (1), i KDF-së.

rëndësishme të fëmijës të parashikuara nga KDF-ja janë: (i) e drejta për t'u dëgjuar¹⁹ në çdo procedurë gjyqësore ose administrative, që ka të bëjë me të; (ii) e drejta për të përfituar nga shërbimet dhe lehtësitë e kujdesit për fëmijët²⁰ në rrethana të veçanta; (iii) e drejta për t'u mbrojtur²¹ nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore përfshirë abuzimin seksual. Për shkak të rëndësisë së tij, abuzimi seksual, është gjithashtu i rregulluar nga një dispozitë e posaçme e KDF-së, Neni 34 i cili fillimisht parashikon parimin se “*Shtetet Palë marrin përsipër të mbrojnë fëmijën nga çdo lloj forme e shfrytëzimit seksual dhe keqtrajtimit seksual*”. Ky parim mbështetet nga veprimet pozitive të shteteve të cilat kanë detyrimin të “*marrin të gjitha masat e duhura në planin kombëtar, dypalësh dhe shumëpalësh për të mos lejuar që: (a) fëmijët të nxiten ose të detyrohen për t'u përfshirë në veprimtari të paligjshme seksuale; (b) fëmijët të shfrytëzohen për qëllime prostitucioni ose praktika të tjera seksuale të paligjshme; (c) fëmijët të shfrytëzohen për shfaqje ose materiale pornografike*”.

3.2. Konventa e Lanzarotë-s

Për shkak të dëmit të konsiderueshëm në zhvillimin e fëmijës, abuzimi seksual i fëmijëve ka qenë objekt i instrumenteve të posaçme ndërkombëtare. Konventa e Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual, është miratuar në Tetor të vitit 2007 në Lanzarote, Spanjë dhe ka hyrë në fuqi në datën 1 Korrik 2010. Konventa e Lanzarotë-s është nënshkruar nga të gjithë 47 anëtarët e KE-së dhe ratifikuar nga 41 prej tyre. Gjithashtu Konventa e Lanzarotë-s është e hapur për aderim nga çdo shtet jo-anëtar i KE-së²². Konventa fillon duke përcaktuar në Parathënien e saj se shfrytëzimi seksual i fëmijëve dhe të gjitha format e abuzimit seksual janë “*shkatërruese për shëndetin dhe zhvillimin psikosocial të fëmijëve*”²³ dhe se kjo dukuri është “*bërë shqetësuese si në nivelin kombëtar ashtu edhe në atë ndërkombëtar*”²⁴. Ajo vazhdon duke përcaktuar se “*fëmijë*” do të konsiderohet çdo person nën moshën 18 vjeç²⁵.

Kuadri normativ i Konventës së Lanzarotë-s përbëhet nga një grup nenesh gjithëpërfshirëse dhe të detajuara që synojnë të mbulojnë dhe rregullojnë të gjitha aspektet e fenomenit të abuzimit seksual të fëmijëve. Në përgjithësi mund të thuhet se është e organizuar në tre shtylla kryesore: (i) masat parandaluese; (ii) masat mbrojtëse dhe ndihmëse dhe së fundmi (iv) masat gjatë procesit të ndjekjes penale.

i. Masat Parandaluese: në përputhje me Nenin 4 të Konventës së Lanzarotë-s, çdo palë duhet të marrë masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për parandalimin e të gjitha formave të abuzimit seksual të fëmijëve. Por cilat janë këto masa dhe cila është natyra e tyre? Pyetja merr menjëherë përgjigje nga nenet vijuese të konventës e cila parashikon një gamë të gjerë masash me natyrë ligjore dhe zbatueshmëri të ndryshme. Ato mund të jenë

¹⁹ Neni 12 (2), i KDF-së.

²⁰ Neni 18, 19, 20 etj. i KDF-së.

²¹ Neni 19 (1). i KDF-së.

²² Dokument informues hartuar nga sekretariati i Komitetit të Lanzarote-s , ip-i datës 26 Maj 2016, fq.1.

²³ Paragrafi 4, Parathënie, Konventa e Lanzarote-s.

²⁴ Paragrafi 5, Parathënie, Ibid.

²⁵ Neni 3 pika (a),.

politika publike, masa administrative ose masa penale, secila e hartuar për të ngritur një sistem parandalimi që ka aftësinë të ndërhyjë në faza të ndryshme të abuzimit seksual të fëmijëve. Kemi politikat e **ndërgjegjesimit/edukimit** të hartuara për një kategori të gjerë subjektsh (fëmijët; personat që punojnë në kontakt me fëmijët; publiku i gjerë) me synimin për të ofruar njohuri për fenomenin e abuzimit seksual të fëmijëve dhe të konceptuara në mënyrë që të jenë të përshtatshme me kategorinë të cilës i adresohen²⁶. Kemi **politikat e trajnimit** që u ofrohen personave që punojnë me fëmijët në sektorë të ndryshëm, si arsimit, shëndetësia, mbrojtja sociale, gjyqësori, organet e zbatimit të ligjit, sporti dhe kultura²⁷. Kemi **masat kufizuese** të tilla si masa parandaluese shumë efektive e përfshirë në Nenin 5 (3) të Konventës së Lanzarotë-s sipas të cilës, personat që janë dënuar për veprime të shfrytëzimit seksual ose abuzimit seksual të fëmijëve përjashtohen nga profesionet që kanë kontakt të rregullt me fëmijët. Kemi masat e bashkërendimit/koordinimit²⁸ sipas të cilave kërkohet që agjencitë dhe institucionet vendore dhe kombëtare që veprojnë në sektorë të ndryshëm në kontakt me fëmijët (arsim; shëndetësi; shërbime sociale; zbatim i ligjit; gjyqësori) të bashkëpunojnë në koordinimin e aktiviteteve të tyre në mënyrë që të ndërtojnë një sistem parandalimi efektiv. Së fundmi, kemi **masat e legjislacionit penal**, të cilat janë masa parandaluese në vetvete për shkak të efektit parandalues që ligji penal mendohet se ka në veprimtarinë kriminale të individëve. Në fakt Konventa e Lanzarotë-s përcakton një sërë dispozitash të hollësishme penale, duke konsideruar si vepra penale disa aktivitete seksuale me fëmijët, më të rëndësishme nga të cilat, për qëllimin e këtij artikulli janë: **Neni 18 – Abuzimi seksual** - i cili përcakton se palët e konventës duhet të parashikojnë si vepër penale sjelljen e qëllimshme të: *‘(a) përfshirjes në aktivitete seksuale me një fëmijë, i cili, sipas dispozitave të legjislacionit të brendshëm, nuk e ka arritur ende moshën ligjore për aktivitete seksuale; (b) përfshirjes në aktivitete seksuale me një fëmijë me mjete shtrënguese, forcë ose kërcënime; kur abuzohet me një pozicion të njohur që gëzon besim, autoritet ose ndikim mbi fëmijët, duke përfshirë edhe marrëdhëniet brenda familjes; kur abuzohet në veçanti me situatën karakteristike të brishtë të fëmijëve, kryesisht për shkak të një paaftësie mendore ose fizike ose të një situatë varësie’*. **Neni 22- Korruptimi i fëmijëve** – në përputhje më të cilin palët e konventës duhet të parashikojnë si vepër penale *‘shkaktimin me qëllim, për qëllime seksuale, të një fëmije ... për të qenë dëshmitar i abuzimit seksual ose i aktiviteteve seksuale, edhe pa iu dashur të marrë pjesë në to’*. **Neni 24** i cili parashikon si vepër penale ndihmën ose lejinin dhe tentativën e abuzimit seksual mbi fëmijën dhe **Neni 28** i cili identifikon disa rrethana rënduese. Vlen të përmendet, se Konventa lë të hapur për shtetet të përcaktojnë **moshën nën të cilën ndalohet përfshirja në aktivitete seksuale të një fëmije**²⁹ - që do të thotë se mund të jetë edhe më e ulët se moshën 18 vjeç. Kjo pavarësisht dispozitës së Nenit 3 që parashikon se fëmijë është çdo person nën moshën 18 vjeç. Kjo ndodh për shkak të faktit se sisteme të ndryshme ligjore parashikojnë moshën të ndryshme ku konsiderohet se personi ka

²⁶ Nenet 5,6 dhe 8, të Konventës së Lanzarotë-s.

²⁷ Neni 5 (1) dhe (2), Ibid.

²⁸ Neni 10, Ibid.

²⁹ Neni 18 (2), i Konventës së Lanzarotë-s.

aftësinë të japë pëlqimin për kryerjen e marrëdhënieve seksuale, madje edhe moshën 14 vjeç³⁰ siç është dhe rasti i Shqipërisë.

- ii. **Masat Mbrojtëse dhe Ndhimëse:** masat mbrojtëse dhe ndihmëse përmenden në Kreun IV të Konventës së Lanzarotë-s. Ato përfshijnë një larmishmëri masash të tilla si: krijimi i **strukturave shumëdisiplinore** që u japin mbështetjen e nevojshme viktimave dhe të afërmeve të tyre të ngushtë³¹; **Raportimi i dyshimit** mbi rastes e abuzimit seksual nga profesionistët që punojnë në kontakt me fëmijët³²; krijimi i shërbimeve të informimit si linja telefonike ose interneti³³; **ndihma e viktimave**, në **kuadrin afatshkurtër dhe afatgjatë**, gjatë rimëkëmbjes së tyre fizike dhe psiko-sociale³⁴; **bashkëpunimi** me organizatat jo-qeveritare dhe/ose shoqërinë civile të angazhuara në ndihmën ndaj viktimave³⁵; **largimi** i autorit ose largimi i viktimës nga mjedisi familjar kur abuzimi seksual i fëmijëve ndodh brenda familjes³⁶.
- iii. **Masat gjatë procesit të ndjekjes penale:** masat gjatë procesit të ndjekjes penale përfshijnë hetimin penal dhe proceset gjyqësore të rasteve të abuzimit seksual të fëmijëve siç parashikohet në Kreun VII të Konventës së Lanzarotë-s. Për shkak të ndjeshmërisë së këtyre proceseve, konventa fillon duke theksuar se hetimet dhe proceset penale duhet të kryhen në përputhje me parimin e *‘interesit më të mirë të fëmijëve’*³⁷, me një *“përqasje mbrojtëse ndaj viktimave”* në mënyrë që të garantohet se hetimi penal dhe procesi gjyqësor *“nuk e përkeqësojnë traumën që kalon fëmija”*³⁸. Si rrjedhojë ekzistojnë disa standarde që duhen ndjekur: **njësitë përgjegjëse për hetimet** duhet të përbëhen nga nëpunës **të trajnuar** për të trajtuar rastet e fëmijëve të abuzuar³⁹; **intervistat** me fëmijët duhet të zhvillohen nga nëpunës të trajnuar, në **ambiente të përshtatshme**, kur është e mundur nga i njëjti person/nëpunës dhe të jenë në një numër të kufizuar me qëllim që fëmija mos të duhet të përjetojë vazhdimisht të njëjtën eksperiencë traumatike⁴⁰. Në mënyrë të ngjashme, gjatë procesit gjyqësor gjyqtari të mund të urdhërojë që **seanca të jetë e mbyllur** dhe viktima të dëgjohej **pa qenë i/e pranishme** në sallën e gjyqit nëpërmjet përdorimit të teknologjive të komunikimit⁴¹. Konventa gjithashtu parashikon disa parime të rëndësishme lidhur me **standardet e hetimit dhe ndjekjes penale**: trajtimin e këtyre rasteve me **përparësi** përse i përket hetimit dhe procedimit penal⁴²; sigurimin e hetimeve dhe ndjekjes penale efektive **duke lejuar operacionet e fshehta**⁴³; fillimin e hetimeve **kryesisht (ex**

³⁰ Neni 100, i Kodit penal shqipëtar.

³¹ Neni 11, i Konventës së Lanzarotë-s .

³² Neni 12 (1), Ibid.

³³ Neni 13, Ibid.

³⁴ Neni 14 (1), Ibid.

³⁵ Neni 14 (2), Ibid.

³⁶ Neni 14 (3), Ibid.

³⁷ Neni 30 (1) i Konventës së Lanzarotë-s.

³⁸ Neni 30 (2) Ibid.

³⁹ Neni 34 (1) Ibid.

⁴⁰ Neni 35 (1) Ibid.

⁴¹ Neni 36 (1) Ibid.

⁴² Neni 30 (3) Ibid.

⁴³ Neni 30 (5) Ibid.

officio) të këtyre veprave penale, pa nevojën e një raportimi ose akuze të ngritur nga viktimat⁴⁴; **vazhdimin e proceseve penale** edhe në rast se viktimat e tërheq deklaraten e tij/saj⁴⁵; caktimi i një afati të mjaftueshëm parashkrimi të veprës penale, që nis pasi viktimat të ketë arritur moshën madhore⁴⁶;

Një tjetër risi dhe mjet i rëndësishëm që sjell Konventa e Lanzarotë-s është detyrimi për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave. Në fakt kërkohet nga palët e konventës që të mbledhin dhe të ruajnë të dhënat të lidhura me identitetin dhe me profilin gjenetik (ADN) të personave të dënuar për abuzim seksual të fëmijëve⁴⁷. Këto të dhëna duhen të kontrollohen nga një autoritet i vetëm kombëtar, i cili duhet të themelohet nga çdo shtet pale dhe t'i komunikohet Sekretarit të Përgjithshëm të KE-së. Zbatimi i të gjithë dispozitave të sipërpërmendura të Konventës së Lanzarotë-s monitorohet nga "Komiteti i Palëve të Konventës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual" ("Komiteti i Lanzarotë-s"). Komiteti i Lanzarotë-s ka funksione monitoruese⁴⁸, që do të thotë se vlerëson zbatimin e parimeve dhe standardeve të konventës nga palët e konventës. E realizon këtë detyrë duke u kërkuar palëve të monitoruara të konventës dhe organizatave të shoqërisë civile, organizatave jo-qeveritare dhe organeve të tjera përkatëse që veprojnë në shtetet anëtare të konventës, plotësimin e një pyetësori. Mbështetur në informacionin e mbledhur, Komiteti i Lanzarotë-s harton raportin e zbatimit i cili përmban vlerësimin dhe rekomandimet përkatëse për palët e konventës. Raporti i parë i zbatimit u miratua nga Komiteti i Lanzarotë-s në vitin 2015 dhe ishte i përqendruar tek një lloj i veçantë abuzimi, konkretisht tek abuzimi seksual i fëmijëve në rrethin e besimit⁴⁹.

3.3. Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)

Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), e cila ka hyrë në fuqi në datën 3 Shtator 1953 është një nga instrumentet ndërkombëtare më aktive për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që vepron nën kuadrin e Këshillit të Europës. Veçoria dhe suksesi i saj qëndron në krijimin e mekanizmit më efektiv të monitorimit ndërkombëtar: Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ). Nëpërmjet vendimeve të GJEDNJ-së, të cilat janë të detyrueshme për palët e Konventës, KEDNJ-ja është bërë një nga instrumentet më efektive të kontrollit ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në fushën e tij të veprimit. Duke qenë një konventë e përgjithshme për të drejtat e njeriut, KEDNJ-ja nuk merret veçanërisht me të drejtat e fëmijëve ose me mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi seksual. Sidoqoftë, të drejtat e fëmijëve mbrohen në mënyrë të tërthortë nga konventa, nëpërmjet mbrojtjes së të drejtave të tjera të përgjithshme të njeriut, të cilat natyrisht zbatohen edhe për fëmijët.

⁴⁴ Neni 32, Ibid.

⁴⁵ Ibid.

⁴⁶ Neni 33, Ibid.

⁴⁷ Neni 37, Ibid.

⁴⁸ Neni 41, i Konventës së Lanzarotë-s.

⁴⁹ Komiteti i Lanzarotë-s, Raporti i parë i zbatimit, "Protection of Children against sexual abuse in the circle of trust: The framework", i datës 4 Dhjetor 2015.

Janë dy të drejta të KEDNJ-së të cilat kanë pasur një ndikim të konsiderueshëm në çështjet që kanë të bëjnë me abuzimin seksual të fëmijëve. Këto janë: **Neni 3 – Ndalimi i torturës** i cili përcakton se “*Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, as dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese*” dhe **Neni 8 – E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare** sipas të cilit “*Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij*”. Përmes këtyre dy dispozitave, GJEDNJ-ja që në fillim të vitit 1985 e më tej ka zhvilluar një bashkësi të qëndrueshme parimesh dhe standardesh të zbatueshme për rastet e abuzimit seksual të fëmijëve. Në fakt, shumë prej parimeve dhe masave që u kodifikuan nga Konventa e Lanzarotë-s në vitin 2007, janë identifikuar më parë përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.

Por si zbatohen këto të parime në rastet e abuzimit seksual të fëmijëve?

Çështjet e abuzimit seksual zakonisht janë paraqitur pranë GJEDNJ-së duke u ankuar për shkeljen e përbashkët të Nenit 3 dhe Nenit 8. Nuk ka asnjë dyshim në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së se abuzimi seksual i fëmijëve kualifikohet si trajtim çnjerëzor ose degradues sipas Nenit 3. Si rrjedhojë, kur ka prova të mjaftueshme për veprimtari të tilla seksuale kundër fëmijëve, GJEDNJ-ja e shqyrton çështjen sipas Nenit 3. Gjykimi i çështjes sipas Nenit 8 kërkohet veçanërisht në rastet kur abuzimi seksual i fëmijëve ndodh brenda familjes ose brenda strukturave ku fëmijët jetojnë (brenda rrethit të besimit). Përmes çështjeve gjyqësore mbështetur kryesisht të këto dy nene, GJEDNJ-ja ka përcaktuar gjatë viteve një grup të rëndësishëm parimesh, më të rëndësishmet nga të cilat janë përmbledhur në mënyrë kronologjike më poshtë:

- i. **Çështja X dhe Y kundër Holandës (1985)**⁵⁰: përmes kësaj çështjeje GJEDNJ-ja ka identifikuar që në vitin 1985 parime të rëndësishme të zbatueshme për masat e ndjekjes penale në rastet e abuzimit seksual me fëmijë me aftësi të kufizuara. Konkretisht, një vajzë me aftësi të kufizuara mendore që jetonte në një strukturë private u abuzua seksualisht kur ishte 16 vjeç, nga një i afërm i drejtoreshës së strukturës. Për shkak të problemeve të saj mendore, vajza nuk ishte në gjendje të bënte vetë një kallëzim penal, gjë që u bë nga babai i saj. Pas pushimit të ndjekjes penale nga Prokurori, babai e apeloj vendimin e pushimit dhe Gjykata e Apelit e rrëzoi apelimin e babait me arsyetimin se vetëm viktimi kishte të drejtë të ndërmerre veprime ligjore⁵¹. GJEDNJ-ja fillon duke theksuar parimin e saj thelbësor sipas të cilit në lidhje me të gjitha të drejtat e KEDNJ-së, përfshirë Nenin 8, shteti nuk ka vetëm detyrimin të shmangë kufizimin e ushtrimit të të drejtave (detyrimi negativ) por ka gjithashtu detyrimin të miratojë masa të cilat garantojnë gëzimin e këtyre të drejtave edhe në sferën e marrëdhënieve individuale (**detyrim pozitiv**)⁵². Në kuadrin e këtij parimi GJEDNJ-ja shqyrtoi nëse legjislacioni në fuqi në Holandë shkelte detyrimin pozitiv të shtetit për të miratuar masa të cilat garantojnë të drejtën e respektimit të jetës private dhe familjare. Në këtë mënyrë përcaktoi dy parime të rëndësishme lidhur me masat e ndjekjes penale. Së pari se çështjet e abuzimit seksual të të miturve janë çështje “*ku janë në rrezik vlerat themelore dhe aspektet thelbësore të jetës private*”⁵³, prandaj parandalimi efektiv

⁵⁰ X dhe Y kundër Holandës, Aplikimi nr. 8978/80, Vendim i datës 26 Mars 1985.

⁵¹ Ibid, §12.

⁵² Ibid, §23.

⁵³ Ibid, §27.

është i domosdoshëm dhe mund të arrihet vetëm me dispozita të ligjit penal⁵⁴. Së dyti se pamundësia e fillimit të procedimit penal për shkak të mungesës së aftësisë së viktimës për të paraqitur një ankesë, nuk ofron një mbrojtje praktike dhe efektive duke shkelur kështu Nenin 8 të KEDNJ-së⁵⁵.

- ii. **Çështja e Scozzari dhe Giunta kundër Italisë (2000)**⁵⁶: çështja lindi për shkak të ankimit të paraqitur në GJEDNJ nga nëna e dy fëmijëve të cilët u hoqën nga kujdestaria e saj dhe u vendosën në një komunitet të fëmijëve me emrin “Il Forteto”. Pavarësisht faktit se ky rast ka të bëjë me situatën e kundërt, të prindërve që pretendojnë shkelje të së drejtës së tyre për respektimin e jetës familjare, ai përmban një grup të rëndësishëm parimesh që lidhen me kujdesin social që u ofrohet fëmijëve të abuzuar seksualisht dhe / ose të lënë pas dore. Një nga problemet në këtë rast ishte se Komuniteti “Il Forteto” kishte qenë nën hetim penal për pedofili dhe dy nga anëtarët e saj themelues ishin dënuar për keqtrajtim dhe abuzim seksual të fëmijëve nën kujdesin e komunitetit⁵⁷. Sidoqoftë, këta dy anëtarë themelues vazhdonin të punonin brenda komunitetit dhe kishin rol shumë aktiv në të. GJEDNJ-ja në radhë të parë përcaktoi se në rastet e largimit, kur vihen në peshore e drejta e prindërve për respektim të jetës familjare dhe të drejtat e fëmijëve, **interesi më i mirë i fëmijës** duhet të konsiderohet me rëndësi të veçantë dhe mund të mbizotërojë⁵⁸. Së dyti, gjykata përcaktoi se kishte rezerva të forta për faktin se autoritetet publike kishin lejuar që fëmijët të vendoseshin nën kujdesin e dy personave të cilët ishin dënuar për keqtrajtim dhe abuzim të fëmijëve të ngarkuar nën kujdesin e tyre⁵⁹. Për këtë shkak dhe rrethanave të tjera të çështjes, GJEDNJ-ja vendosi se “*autoritetet kanë dështuar të tregojnë shkallën e maturisë dhe vigjilencës së kërkuar në një situatë kaq delikate dhe të ndjeshme dhe e kanë bërë këtë në dëm ... të interesit më të lartë të fëmijës*”⁶⁰ dhe se ka pasur si pasojë shkelje të Nenit 8 të KEDNJ-së.
- iii. **Çështja e E. dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar (2002)**⁶¹: çështja lindi për shkak të ankimit të depozituar pranë GJEDNJ-së nga katër shtetas të cilët pretendonin se kur ishin fëmijë kishin vuajtur abuzime seksuale dhe fizike nga partneri bashkëjetues i nënës së tyre, abuzim i cili kualifikohej si trajtim çnjerëzor dhe poshtëruar sipas Nenit 3 të KEDNJ-së. Nëpërmjet këtij vendimi, GJEDNJ-ja përcaktoi dhe bëri bashkë disa parime të rëndësishme lidhur me detyrimet pozitive të shtetit në këto lloj çështjesh. Së pari parashikoi se shteti është nën detyrimin pozitiv për të marrë masa që sigurojnë që subjektet nën juridiksionin e tij nuk janë subjekt i trajtimit çnjerëzor ose poshtëruar⁶². Këto masa duhet të ofrojnë mbrojtje efektive, sidomos kur ka fëmijë të përfshirë dhe duhet të përmbajnë hapa të arsyeshëm për të parandaluar keqtrajtimin për të cilin **autoritetet kanë dënuar ose**

⁵⁴ Ibid,

⁵⁵ Ibid, §29.

⁵⁶ Scozzari dhe Giunta kundër Italisë, Aplikimi nr. 39221/98 dhe 41963/98, Vendim i datës 13 Korrik, 2000.

⁵⁷ Ibid, §31 dhe 32.

⁵⁸ Ibid, §31

⁵⁹ Scozzari dhe Giunta kundër Italisë, Aplikimi nr. 39221/98 dhe 41963/98, §206, Vendim i datës 13 Korrik 2000. §206.

⁶⁰ Ibid, §216.

⁶¹ E dhe të Tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, Aplikimi nr. 33218/96, Vendim Përfundimtar i datës 15 Janar 2003,.

⁶² Ibid, §88.

duhet të kishin pasur dijeni⁶³. U konstatua se dështimi për një kohë të gjatë i autoritetit vendor për të mbrojtur fëmijët nga abuzimet për të cilat ishte në dijeni, ishte në shkelje të detyrimeve të Nenit 3⁶⁴. Ky dështim vinte si pasojë e mungesës së hetimit, mungesës së bashkëpunimit dhe komunikimit ndërmjet autoriteteve të përfshira në rastin aktual, pra dështimi për të ndërmarrë hapat e duhura⁶⁵.

- iv. **Çështja e E. S, dhe të Tjerë kundër Sllovakisë (2009)**⁶⁶: rasti lindi për shkak të abuzimit seksual të një babai ndaj fëmijës së tij dhe abuzimit fizik ndaj gruas së tij. Aplikantët u ankuan në GJEDNJ se shteti Sllovak kishte dështuar t'u siguronte atyre mbrojtjen e nevojshme kundër abuzimit, që përbëhej nga trajtimi çnjerëzor dhe poshtërues sipas Nenit 3 të KEDNJ-së dhe t'u siguronte respektimin e jetës së tyre private dhe familjare sipas Nenit 8 të KEDNJ-së⁶⁷, sepse nuk kishte miratuar një urdhër të përkohshëm për të larguar abuzuesin nga banesa familjare. Pasi shqyrtoi legjislacionin Sllovak dhe çështjen para saj, GJEDNJ-ja konstatoi se dështimi për të nxjerrë masën e përkohshme të largimit tregoi se shteti dështoi të përmbushë detyrimet e tij pozitive për të mbrojtur të drejtat e aplikantëve të përcaktuara nga nenet 3 dhe 8, duke shkaktuar kështu një shkelje të këtyre të drejtave⁶⁸.

3.4. Legjislacioni i Bashkimit Europian

Bashkimi Europian është një organizatë tjetër ndërkombëtare e cila është shumë aktive në disa fusha dhe prodhon një bashkësi koherente legjislacioni, të detyrueshëm për shtetet anëtare të tij. Përveç legjislacionit të tregut të brendshëm, me miratimin e Kartës së BE-së për të Drejtat Themelore (*Karta e BE-së*), BE-ja përfshiu zyrtarisht brenda legjislacionit të saj një qasje të të drejtave të njeriut. Rruga drejt miratimit të Kartës së BE-së filloi në vitin 2007, me shpalljen e saj në Këshillin Europian të Nicës më 7 dhjetor 2000, në atë kohë pa efekte ligjore detyruese dhe u mbyll në vitin 2009 me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës më 1 dhjetor 2009. Vetëm në këtë moment Karta e BE-së fitoi vlerë ligjore detyruese dhe siç u përcaktua shprehimisht në Nenin 6 (1) të Traktatit të Bashkimit Europian (TBE) ajo ka tashme vlerë të njëjtë ligjore me vetë Traktatet e BE-së⁶⁹. Si rrjedhojë, të drejtat e njeriut të përfshira dhe të njohura në Kartën e BE-së janë të detyrueshme si për institucionet dhe organet e BE-së, ashtu edhe për autoritetet kombëtare të shteteve anëtare të BE-së kur zbatojnë të drejtën europiane.

Karta e BE-së njeh të drejtat e fëmijës dhe i rregullon ato në një dispozitë të posaçme, në Nenin 24 i cili përmban parimet e **mbrojtjes dhe kujdesit të fëmijëve** dhe **mirëqenies së tyre**⁷⁰ dhe marrjen në konsideratë të **interesit më të mirë të fëmijës**⁷¹ nga të gjitha institucionet publike ose private. Por BE-ja nuk është mjaftuar vetëm me përfshirjen e të drejtave të fëmijëve në Kartën e

⁶³ Ibid.

⁶⁴ Ibid.

⁶⁵ Ibid, §100.

⁶⁶ E.S. dhe të Tjerë kundër Sllovakisë, Aplikimi nr. 8227/04, Vendim Përfundimtar i datës 15 Dhjetor 2009.

⁶⁷ Ibid, §25.

⁶⁸ Ibid, §44.

⁶⁹ ec.europa.eu/justice/fundamental-rights/charter/index_en.htm

⁷⁰ Neni 24 (1) i Kartës së BE-së.

⁷¹ Neni 24 (2), Ibid.

BE-së. Ajo ka shfrytëzuar një nga funksionet e saj legislative specifike, atë të miratimit të legjislacionit të detyrueshëm në fushën shumë delikate të legjislacionit penal dhe ka miratuar një direktivë që rregullon abuzimin seksual të fëmijëve. Kjo është Direktiva 2011/92/EU Parlamentit Europian dhe e Këshillit, e datës 13 Dhjetor 2011 “*Për luftën kundër abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve...*” (Direktiva 2011/92) e cila përmban rregullat minimale për përcaktimin e veprave penale dhe sanksioneve në fushën e abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe dispozitat për të forcuar parandalimin e krimeve seksuale ndaj fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre. Në mënyrë të ngjashme me Konventën e Lanzarotë-s, Direktiva 2011/92 përcakton një sërë masash parandaluese, mbrojtëse, ndihmëse, mbështetëse dhe masa të ndjekjes penale dhe parime të zbatueshme në rastet e abuzimit seksual të fëmijëve. Risia është se kur përcaktohen dispozitat materiale të ligjit penal, direktiva përcakton gjithashtu afatet minimale të burgimit për çdo vepër penale. Përsëmbull, Neni 3 (2) parashikon një dënim minimal prej një viti burgim, në rastet kur një fëmijë detyrohet të jetë dëshmitar gjatë kryerjes së marrëdhënieve seksuale; Neni 3 (4) parashikon një afat minimal prej 5 vitesh burgim për rastet e kryerjes së aktiviteteve seksuale me fëmijët që nuk kanë arritur moshën e pëlqimit seksual, e kështu me radhë. Një tjetër risi e sjellë nga Direktiva 2011/92 është përfshirja e masës kufizuese mjaft efektive, e cila është parashikuar gjithashtu në Konventën e Lanzarotë-s, masa e përrjashtimit të përkohshëm ose të përhershëm të personave të dënuar për vepra penale që lidhen me abuzimin seksual dhe shfrytëzimin seksual të fëmijëve, nga aktivitetet që përfshijnë kontakte të drejtpërdrejta dhe të rregullta me fëmijët⁷². Kjo masë përfshin mundësinë e punëdhënësve për të kërkuar dhe marrë nga personat të cilët aplikojnë për vende pune në kontakt të drejtpërdrejtë dhe të rregullt me fëmijët, dëshminë e penalitetit për ekzistencën e këtyre lloj veprave penale kundër fëmijëve⁷³. Së fundmi duhet të përmendet se është e rëndësishme fakti se ekziston një direktivë e BE-së mbi këtë çështje sepse shtetet anëtare të BE-së janë të detyruara të transpozojnë në legjislacionin e tyre të brendshëm rregullat minimale penale të miratuara nga Direktiva 2011/92, si dhe masat parandaluese, mbrojtëse, ndihmëse, mbështetëse, masat e ndjekjes penale dhe parimet e direktivës. Vetë karakteristikat e direktivës së bashku me faktin se mekanizmat e monitorimit dhe kontrollit në kuadrin e BE-së janë më të forta dhe me impakt më të madh se çdo akt tjetër që rrjedh nga legjislacioni ndërkombëtar, e bën Direktivën 2011/92 një pjesë themelore të legjislacionit ndërkombëtar mbi mbrojtjen e fëmijëve kundër abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual.

IV. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL SHQIPTAR

Kuadri ligjor shqiptar për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi seksual përbëhet nga dispozita kushtetuese, ratifikimi i instrumenteve ndërkombëtare, legjislacioni vendas, aktet nënligjore dhe procedurat administrative. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë trajton të drejtën e fëmijës në nenin 54 të saj dhe parashikon, ndër të tjera parimin se: çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi dhe shfrytëzimi që mund të dëmtojë shëndetin e tij/saj, moralin ose të

⁷² Neni 10 (1), Direktiva 2011/92/EU e e Parlamentit Europian dhe e Këshillit të datës 13 Dhjetor 2011 “*për luftimin e abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografinë e fëmijëve dhe zëvendësimin e vendimit të Këshillit 2004/68/JHA*”

⁷³ Neni 10 (2), Ibid.

rrzekojë jetën e tij/saj dhe zhvillimin normal⁷⁴. Përveç dispozitave kushtetuese, Shqipëria ka ratifikuar gjithashtu konventat ndërkombëtare për të drejtat e fëmijës të sipërpërmendura, dhe konkretisht: (i) ka ratifikuar KDF-në nëpërmjet Ligjit nr. 7531, datë 11.12.1991 “Për ratifikimin e Konventës për të drejtat e fëmijëve”; (ii) ka ratifikuar KEDNJ-në nëpërmjet Ligjit nr. 8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e Konventës Europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” duke u bërë një shtet anëtar i KEDNJ-së; (iii) ka ratifikuar Konventën e Lanzarotë-s nëpërmjet Ligjit nr. 10 071, datë 9.2.2009 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual”. Si rrjedhojë, dispozitat e konventave ndërkombëtare të ratifikuara tashmë janë pjesë e legjislacionit të brendshëm shqiptar. Duhet të theksohet se, në lidhje me BE-në, Shqipëria është një vend kandidat, pra ende nuk është e detyruar të transpozojë direktivat e BE-së. Megjithatë për shkak të angazhimit të saj drejt integritimit në BE është në procesin e përafrimit të legjislacionit të saj me legjislacionin e BE-së në fusha të ndryshme. Dispozitat kushtetuese dhe konventat ndërkombëtare të ratifikuara kanë nevojë për ligje të veçanta kombëtare, akte nënligjore, procedura administrative dhe institucione për t'u bërë të zbatueshme. Si rrjedhojë, gjatë gjithë këtyre viteve, ligjvënësi shqiptar ka hartuar dhe miratuar një sërë ligjesh kombëtare që rregullojnë aspekte të ndryshme të të drejtave të fëmijëve. Kjo bashkësi normash përbëhet nga ligji organik specifik për të drejtën e fëmijës, kodi penal, kodi i procedurës penale dhe e reja më e fundit legjislative, kodi i drejtësisë penale për të miturit.

4.1. Ligji për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës

Ligji nr. 18/2017 datë 23.02.2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” (Ligji 18/2017) është ligji organik i cili përcakton parimet e përgjithshme, masat, standardet e mbrojtjes dhe kuadrin institucional për të drejtat e fëmijëve. Duhet të theksohet menjëherë se ky ligj i miratuar së fundmi, i cili shfuqizon dhe zëvendëson ligjin e vitit 2010 që rregullonte të njëjtën çështje, përbën një përmirësim të dukshëm të legjislacionit shqiptar në këtë fushë. Kjo vjen si pasojë e faktit se ligji i ri ka përfshirë dhe rregulluar në mënyrë të detajuar dhe sistematike parimet, standardet dhe masat e parashikuara në Konventën e Lanzarotë-s dhe në instrumentet ndërkombëtare të përmendura më sipër. Pasi ka parashikuar se me ‘fëmijë’ do të kuptohet çdo person nën moshën 18 vjeç⁷⁵ dhe ka përmendur parimin e mirënjohur të interesit më të lartë të fëmijës⁷⁶, Ligji nr. 18/2017 përcakton: (i) **masat parandaluese** të tilla si: trajnime, fushata për rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimit për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi drejtuar personave që punojnë me fëmijët, punonjësve të administratës publike dhe qytetarëve⁷⁷; kufizime të punësimit në kontakt me fëmijët për shtetasit që janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale kundër personit, ose ndaj të cilëve janë marrë, me vendim gjykate, një nga masat mbrojtëse të parashikuara për dhunën në familje⁷⁸; pezullimi i punësimit për shtetasit që punojnë më fëmijët kur ndaj tyre fillon një procedim penal për vepra penale të kryera ndaj

⁷⁴ Neni 54 (3), i i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

⁷⁵ Neni 3 (4), Ligji nr. 18/2017 datë 23.02.2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

⁷⁶ Neni 5 (2), Ibid.

⁷⁷ Neni 43 (2), Ibid.

⁷⁸ Neni 45 (1), Ibid.

fëmijës⁷⁹; (ii) **masat ndihmëse dhe mbështetëse** të tilla si: ndihmë juridike dhe psikologjike falas gjatë çdo procesi administrativ dhe ligjor që përfshin fëmijët⁸⁰; **masa bashkërenduese** ndërmjet një sërë institucioneve dhe krijimi i grupit teknik ndërsektorial në çdo njësi që ka mbi 3000 fëmijë⁸¹; vendosja e linjave telefonike ndihmëse për fëmijë⁸²; **detyrimi për raportim për çdo person** që ka informacion për abuzim të fëmijës, çdo person që punon në kontakt me fëmijët përfshirë, detyrimin e posaçëm të raportimit për mësuesit dhe ofruesit e shërbimit psiko-social⁸³ (iii) **masat mbrojtëse** të tilla si: masat e përkujdesjes alternative⁸⁴ si shpërngulja dhe vendosja e fëmijës në familjen të afërmve e tij, në një familje kujdestare ose në një institucion të përkujdesit për fëmijët, për një periudhë të shkurtër kohe, sipas parimit se i jepet përparësi vendosjes së fëmijës në një mjedis familjar; masa emergjente të mbrojtjes⁸⁵ si largimi i fëmijës nga familja dhe vendosjen në përkujdesje alternative; masat për mbikëqyrje të specializuara të fëmijës brenda mjedisit familjar⁸⁶; hartimin e Planit Individual të Mbrojtjes për çdo fëmijë i cili përmban një sërë masash të përgjithshme për fëmijën, përfshirë masat për ndërhyrje dhe hetim të menjëhershëm, masat e kujdesit shëndetësor, mbështetje psikologjike dhe juridike, mbështetje sociale dhe çdo shërbim tjetër të nevojshëm për rehabilitimin dhe ri-integrimin e fëmijës së abuzuar.

Vlen të theksohet se një risi e Ligjit nr. 18/2017 është ngritja e regjistrimit elektronik kombëtar⁸⁷ që përmban rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Këto të dhëna do të grumbullohen dhe do të menaxhohen në nivel kombëtar nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF). Ligji nuk parashikon ndonjë dispozitë materiale të së drejtës penale ose ndonjë masë të ndjekjes penale, sepse të dyja janë të rregulluara nga Kodi Penal dhe nga kodi i ri i drejtësisë penale për të mitur. Përveç risive të sipër përmendura, Ligji nr. 18/2017 krijon një kuadër institucional të mirë- organizuar, me disa organe që ushtrojnë funksione të ndryshme në nivel qendror dhe vendor. Është pozitiv fakti se funksionet e çdo organi përshkruhen në mënyrë të detajuar dhe të strukturuar, siç përmbledhet më poshtë:

- i. **Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (KKDMF):** është një organ këshillimor i cili ka si detyrë kryesore këshillimin dhe bashkërendimin e politikave shtetërore për garantimin e të drejtave të fëmijës⁸⁸. Një detyrë e rëndësishme e këtij organi është vlerësimi i planifikimit të buxhetit nga perspektiva e të drejtave të fëmijëve⁸⁹ dhe dhënia e rekomandimeve të posaçme për autoritetet qendrore dhe agjencive përgjegjëse për të drejtat e fëmijëve.

⁷⁹ Neni 45 (2), Ibid.

⁸⁰ Neni 29 (1),

⁸¹ Neni 52 (1)

⁸² Neni 68, Ibid.

⁸³ Neni 67 (1), (2), (3) and (4), Ibid.

⁸⁴ Neni 31 (1) and (2), Ibid.

⁸⁵ Neni 55 (1) (a), Ibid.

⁸⁶ Neni 55 (1) (c), Ibid.

⁸⁷ Neni 38 (2) (ë), i Ibid, Ligjit nr. 18/2017 datë 23.02.2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

⁸⁸ Neni 35 (1) dhe (2), Ibid,

⁸⁹ Neni 36 (b) dhe (2), Ibid,

- ii. **Ministri që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës**⁹⁰: është autoriteti kryesor përgjegjës për këtë fushë. Ai ka funksione koordinuese në politikat për të drejtat e fëmijëve; funksione monitorimi në lidhje me zbatimin e politikave dhe masave funksione kontrolli mbi veprimtarinë e ASHDMF-së; funksione mbështetëse për organizatat jo-qeveritare që veprojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve merr masa, në bashkëpunim me ministrat e tjerë, për ngritjen dhe mirëfunksionimin e një sistemi të integruar të mbrojtjes së fëmijës nëpërmjet shërbimeve shumëdisiplinore; siguron ngritjen e një sistemi akreditimi, për kontrollin e cilësisë të strukturave të mbrojtjes së fëmijës; krijon dhe ngrë Regjistrin Elektronik Kombëtar për rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje.
- iii. **Ministrat e tjerë të linjës**: Ministrat e tjerë të linjës, brenda fushës së veprimtarisë së tyre shtetërore kanë detyra politikëbërëse në lidhje me të drejtat e fëmijëve. Një detyrë e rëndësishme është të parashikojnë në planet vjetore apo shumëvjeçare buxhetore fondet e nevojshme për përmbushjen e të drejtave të fëmijës dhe për mbrojtjen e fëmijës⁹¹.
- iv. **Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF)**⁹²: është agjencia kombëtare qendrore e cila ushtron një sërë kompetencash të rëndësishme në lidhje me të drejtat e fëmijëve në Shqipëri, të tilla si: organizimi dhe koordinimi i sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës⁹³; mbështetje të drejtpërdrejtë ndaj strukturave të mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor duke përfshirë trajnime, asistencë në menaxhimin e rasteve, mbikëqyrje të rasteve të caktuara, këshillim etj.⁹⁴; mbledhja e të dhënave në nivel kombëtar dhe administrimi i regjistrit elektronik kombëtar për rastet e fëmijës në nevojë për mbrojtje⁹⁵; bashkërendimi i punëve me ministrinë përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve; realizimi i fushatave ndërgjegjësuere dhe edukative.
- v. **Bashkitë**: janë përgjegjëse për ngritjen në nivel bashkie dhe në nivel njësie administrative të një sistemi të integruar të mbrojtjes së fëmijës duke siguruar ndërmjet të tjerash⁹⁶: zhvillimin e programeve dhe projekteve⁹⁷; mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave, në bashkëpunim me institucionet e tjera; ngritjen e strukturave të mbrojtjes së fëmijës⁹⁸; zbatimin e procedurës për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje ngritjen dhe koordinimin e sistemit të referimit, raportimit, të marrjes në mbrojtje dhe të mbikëqyrjes në vazhdim⁹⁹; organizimin dhe ofrimin e shërbimeve për fëmijët në nevojë për mbrojtje, shërbimeve mbështetëse për familjet si dhe shërbimeve të përkujdesjes alternative për fëmijët¹⁰⁰; ngritjen e programeve dhe të shërbimeve rehabilituese e ri-

⁹⁰ Neni 38, Ibid,

⁹¹ Neni 39, (ç) Ibid,

⁹² Neni 40, Ibid,

⁹³ Neni 41, (1) Ibid,

⁹⁴ Neni 41, (2) Ibid.

⁹⁵ Neni 41, (3) (a) Ibid, i Ligjit nr. 18/2017 datë 23.02.2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

⁹⁶ Neni 46, Ibid,

⁹⁷ Neni 46, (c), Ibid,

⁹⁸ Neni 46, (dh), Ibid,

⁹⁹ Neni 46, (e), Ibid,

¹⁰⁰ Neni 46, (ë), Ibid,

integruese për fëmijët në nevojë për mbrojtje, veçanërisht për fëmijët viktime të dhunës¹⁰¹; etj.

- vi. **Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki:** këto struktura janë në përgjithësi përgjegjëse për çështjet e mbrojtjes së fëmijës si dhe kryejnë disa funksione specifike të mbrojtjes së fëmijëve të tilla si: raportimi tek kryetari i bashkisë dhe këshilli bashkiak për ecurinë e rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë¹⁰²; ngritja e grupit teknik ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijës në nivel bashkie si dhe koordinimi dhe mbikëqyrja e punës dhe aktivitetit të tij¹⁰³. Duhet të përmendet se këto struktura kryejnë gjithashtu detyra shumë të rëndësishme në lidhje me **miratimin e masave mbrojtëse** pasi është **Drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore** i cili vendos për marrjen e masave mbrojtëse, për miratimin dhe koordinimin e zbatimit të Planit Individual të Mbrojtjes si dhe për marrjen e masave emergjente 24-orëshe, të cilat më pas i njoftohen strukturave të Policisë së Shtetit¹⁰⁴. Për më tepër të gjitha funksionet që lidhen me çështjet e administrimit të përditshëm të rasteve individuale të fëmijëve ushtrohen nga një njësi e posaçme që funksionon brenda kësaj strukture,¹⁰⁵ **Njësia për mbrojtjen e fëmijës**. Njësia për mbrojtjen e fëmijës, përbëhet nga punonjës socialë, të quajtur **punonjësit për mbrojtjen e fëmijës**, të cilët kanë për detyrë ndjekjen e rasteve të fëmijëve viktime që nga origjina/identifikimi i rastit deri te miratimi i masave dhe zbatimi i tyre. Punonjësit për mbrojtjen e fëmijës kanë, ndër të tjera, disa detyra domethënëse të tilla si: të propozojnë masa mbrojtëse¹⁰⁶; të propozojnë ndryshimin apo përfundimin e Planit Individual të Mbrojtjes¹⁰⁷; të marrin pjesë në proceset gjyqësore në të cilat shqyrtohen masat e mbrojtjes të propozuara në Planin Individual të Mbrojtjes¹⁰⁸; t'i drejtohen prokurorit për heqjen e përgjegjësisë prindërore¹⁰⁹; të ndihmojnë fëmijën dhe/ose familjen e fëmijës në hartimin dhe dërgimin e ankesave pranë Avokatit të Popullit apo autoriteteve të tjera përgjegjëse¹¹⁰.
- vii. **Grupi teknik ndërsektorial:** Në çdo bashki dhe në çdo njësi administrative bashkiake, e cila ka mbi 3000 fëmijë, krijohet grupi teknik ndërsektorial i posaçëm (*ad-hoc*) i cili trajton rastet e fëmijës në nevojë për mbrojtje¹¹¹. Ai përbëhet nga përfaqësues të strukturave të policisë, strukturave të shërbimeve shoqërore, strukturave arsimore, shëndetësore, të drejtësisë, të organizatave jo-qeveritare, si dhe çdo specialist tjetër që ka njohuri për situatën e fëmijës së abuzuar¹¹². Grupi teknik ndërsektorial mbështet punonjësit e mbrojtjes

¹⁰¹ Neni 46, (f), Ibid,

¹⁰² Neni 47, (2), Ibid,

¹⁰³ Neni 47, (3), Ibid,

¹⁰⁴ Neni 48, Ibid,

¹⁰⁵ Neni 49, Ibid,

¹⁰⁶ Neni 59, (2), Ibid

¹⁰⁷ Neni 51, (e), Ibid,

¹⁰⁸ Neni 51, (f), Ibid,

¹⁰⁹ Neni 51, (g), Ibid, i Ligjit nr. 18/2017 datë 23.02.2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

¹¹⁰ Neni 51, (gj), Ibid,

¹¹¹ Neni 52, (1), Ibid,

¹¹² Neni 52, (2), Ibid,

së fëmijës dhe lehtëson referimin dhe menaxhimin e rastit dhe zbatimin e masave të posaçme¹¹³.

4.2. Kodi Penal

Dispozitat materiale të ligjit penal lidhur me abuzimin seksual të fëmijëve përfshihen dhe përcaktohen në Kodin Penal Shqiptar. Si vërejtje e përgjithshme mund të thuhet se KP-ja parashikon dënime të larta për veprat penale të abuzimit seksual duke parashikuar në dënime me burgim shumë-vjeçar. Të paktën disa prej këtyre veprave penale parashikojnë dënime mjaft më të larta se dënimet minimale të parashikuara për vepra penale të ngjashme nga Direktiva 2011/92 /BE. Tre janë nenet të cilat trajtojnë në mënyrë të posaçme abuzimin seksual të fëmijëve, Neni 100, Neni 101 dhe Neni 108. Nenet e tjera, që rregullojnë aspekte të ndryshme të abuzimit seksual, janë klauzola të përgjithshme, të cilat përfshijnë veprime të dënueshme kundër fëmijëve si një rrethanë rënduese. Më konkretisht, dispozitat e mëposhtme penale materiale trajtojnë llojet e ndryshme të abuzimit seksual përfshirë abuzimin seksual ndaj fëmijëve:

- i. **Neni 100 – Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur:** kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me fëmijë të mitur, që nuk ka arritur moshën 14 vjeç ose me të miturën që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, dënohet me burgim nga 7 deri në 15 vjet¹¹⁴. Ky nen parashikon këto rrethana rënduese: marrëdhënie seksuale e kryer në bashkëpunim, më shumë se një herë ose me dhunë ose kur i janë shkaktuar fëmijës së dëmtuar pasoja të rënda për shëndetin dënohet me burgim jo më pak se 25 vjet¹¹⁵; kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e fëmijës së mitur dënohet me burgim jo më pak se 30 vjet ose me burgim të përjetshëm¹¹⁶.
- ii. **Neni 101 – Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç:** kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me dhunë me fëmijë të mitur në moshën 14-18 vjeç që ka arritur pjekurinë seksuale dënohet me burgim nga 5 deri në 15 vjet¹¹⁷. Ky nen parashikon këto rrethana rënduese: kur marrëdhënia seksuale me dhunë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose kur fëmijës së dëmtuar i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga 10 deri në 20 vjet¹¹⁸; kur ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e fëmijës së mitur dënohet me burgim jo më pak se 20 vjet¹¹⁹.
- iii. **Neni 106 – Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari:** Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale ndërmjet prindit dhe fëmijës, vëllait dhe motrës, ndërmjet personave të tjerë që janë gjini në vijë të drejtë ose me persona që ndodhen në raporte kujdestarie ose të birësimit, dënohet me burgim deri në 7 vjet.

¹¹³ Neni 52, (5), Ibid,

¹¹⁴ Neni 100, par (1), i Kodit Penal.

¹¹⁵ Neni 100, par (2), i Kodit Penal.

¹¹⁶ Neni 100, par (3), i Kodit Penal.

¹¹⁷ Neni 101, par 1, i Kodit Penal.

¹¹⁸ Neni 101, par (2),i Kodit Penal.

¹¹⁹ Neni 101, par (3),i Kodit Penal.

- iv. **Neni 107/a – Dhuna seksuale:** ushtrimi i dhunës seksuale, nëpërmjet kryerjes së veprimeve me natyrë seksuale në trupin e një personi tjetër me objekte, përbën veprë penale dhe dënohet me burgim nga 3 deri në 7 vjet¹²⁰. Rrethanat rënduese përfshijnë: kryerjen e kësaj veprë ndaj **fëmijëve të moshës 14 deri në 18 vjeç** që dënohet me burgim nga 5 deri në 15 vjet¹²¹ dhe kryerjen e kësaj veprë ndaj **ndaj një të mituri që nuk ka arritur moshën 14 vjeç**, apo një të mituri që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, pavarësisht nëse kryhet me dhunë apo jo që dënohet me burgim jo më pak se 20 vjet¹²².
- v. **Neni 108 – Vepra të turpshme:** kryerja e veprave të turpshme me të mitur që nuk kanë arritur moshën 14 vjeç dënohet me burgim nga 3 deri në 7 vjet¹²³. Po kjo veprë, kur kryhet ndaj një të mituri që nuk ka arritur moshën 14 vjeç me të cilin autori ka marrëdhënie familjare, dënohet me burgim nga 5 deri në 10 vjet¹²⁴. Përfshirja e qëllimshme si dëshmitar, në veprime me natyrë seksuale, e një të mituri që nuk ka arritur moshën 14 vjeç apo i një të mituri që nuk ka arritur pjekurinë seksuale përbën veprë penale dhe dënohet me burgim nga 1 deri në 5 vjet¹²⁵;
- vi. **Neni 108/a – Ngacmimi seksual:** kryerja e sjelljeve me natyrë seksuale, që cenojnë dinjitetin e një personi, me çdo mjet ose formë, duke krijuar një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues, përbën veprë penale dhe dënohet me burgim nga 1 deri në 5 vjet¹²⁶. Është rrethanë rënduese kur vepra penale kryhet kundër fëmijëve, në këtë rast dënimi është nga 3 deri në 7 vjet burgim¹²⁷.

Është me interes të përmendet se KP-ja parashikon gjithashtu veprat penale të kryerjes e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me kërcënimin e armëve në Nenin 104 dhe të kryerjes së marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën në Nenin 105 . Këto nene kanë një zbatim të përgjithshëm dhe nuk parashikojnë rrethana rënduese të veçanta kur abuzimi u drejtohet fëmijëve siç ishte rasti për disa prej neneve të sipër përmendura. Gjithashtu, duhet të theksohet se veprat penale kundër fëmijëve, të cilat mund të jenë me natyrë seksuale ose të një natyre tjetër trajtohen edhe në pjesë të tjera të Kodit Penal . Për shembull në Seksionin VIII të KP-së të quajtur ‘Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit’ parashikohet nga Neni 117 vepra penale e **pornografisë**. Pavarësisht formulimit të përgjithshëm të titullit të Nenit 117 - gjë që të bën të mendosh se pornografia si e tillë përbën një veprë penale në Shqipëri– kjo veprë në fakt lidhet vetëm me **pornografinë e fëmijëve** dhe nuk dënon pornografinë në vetvete, ose pornografinë ndër personave të moshës madhore. Për më tepër Seksioni IX i KP-së i quajtur ‘Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes’ parashikon një sërë veprash penale kundër fëmijëve të ndryshme nga dhuna seksuale që lidhen me abuzimin ose mungesin e kujdesit ndaj fëmijëve.

¹²⁰ Neni 107/a, par (1), i Kodit Penal.

¹²¹ Neni 107/a, par (2), i Kodit Penal.

¹²² Neni 107/a, par (3), i Kodit Penal.

¹²³ Neni 108, par (1), i Kodit Penal.

¹²⁴ Neni 108, par (2), i Kodit Penal.

¹²⁵ Neni 108, par (3), i Kodit Penal.

¹²⁶ Neni 108/a, par (1), i Kodit Penal.

¹²⁷ Neni 108/a, par (2), i Kodit Penal.

KP-ja rregullon gjithashtu parashkrimin e ndjekjes penale . në Nenin 66 ku përcaktohet se ndjekja penale parashkruhet në rast se nga kryerja e veprës penale deri në marrjen e personit si të pandehur kanë kaluar disa afate të përcaktuara. Kohëzgjatja e afatit të parashkrimit lidhet me kohëzgjatjen e burgimit të përcaktuar për veprat penale dhe përkatësisht: : (a) parashkrim 40 vjet për krimet që parashikojnë dënim me burgim të përjetshëm; (b) parashkrim 20 vjet për krimet që parashikojnë dënim jo më të ulët se 10 vjet ose dënim tjetër më të rëndë; (c) parashkrim 10 vjet për krimet që parashikojnë dënim nga 5-10 vjet burgim; (ç) parashkrim 5 vjet për krimet që parashikojnë dënim deri në 5 vjet burgim ose gjobë; (d) parashkrim 3 vjet për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim deri në 2 vjet burgim; (dh) parashkrim 2 vjet për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim me gjobë. Nuk ekziston ndonjë afat i posaçëm parashkrimi për veprat penale të abuzimit seksual kundër fëmijëve, si rrjedhojë edhe këto vepra penale i nënshtrohen afateve të përgjithshme të parashkrimit të parashikuara nga Neni 66 K.P.

4.3. Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur

Një zhvillim i rëndësishëm në legjislacionin shqiptar për të drejtat e fëmijëve është miratimi i KDPM-së në Mars të vitit 2017 i cili parashikohet të hyjë në fuqi në 1 janar 2018 . Është hera e parë që Shqipëria zhvillon një sërë normash për të rregulluar pozitën e fëmijëve brenda sektorit të drejtësisë penale dhe miraton rregulla dhe procedura specifike të nevojshme për trajtimin e kësaj kategorie të brishtë. KDPM-ja kryesisht ka si qëllim rregullimin e aspekteve të përgjegjësisë penale të fëmijëve që kryejnë vepra penale, por përmban gjithashtu dispozita të rëndësishme në lidhje me fëmijët viktime të krimeve, përfshirë edhe abuzimin seksual. Në fakt, KDPM-ja rregullon çështje të tilla si: pozita e fëmijës viktimë gjatë hetimit dhe ndjekjes penale; intervistat me fëmijët; masat mbrojtëse gjatë gjithë procesit, në mënyrë që të mos përkeqësohet trauma e tyre; mbrojtjen e të dhënave personale të fëmijëve viktime dhe çështje të ngjashme. Pra, të gjitha aspektet të cilat janë përmendur dhe janë nxitur të rregullohen nga disa prej instrumenteve ndërkombëtare të shpjeguara në paragrafet e mësipërme të këtij shkrimi.

KDPM-ja fillon duke shpallur parimin e mbrojtjes së të miturve dhe në interes më të lartë të tyre¹²⁸ dhe duke përcaktuar se “i mitur” është çdo person nën moshën 18 vjeç¹²⁹. Më pas nëpërmjet një sërë dispozitash të detajuara rregullon pozicionin e fëmijës brenda sistemit të drejtësisë penale, qoftë në statusin e të pandehurit, të dënuarit apo të viktimës. Për qëllim të këtij shkrimi, do të përmbledhen më poshtë vetëm dispozitat kryesore të KDPM-së që zbatohen për fëmijët viktime të abuzimit seksual:

- i. **Neni 17 - Shqyrtimi pa vonesë dhe me përparësi:** parashikon parimin se çdo organ kompetent duhet të shqyrtojë në mënyrë të shpejtë dhe me përparësi çështjet me të miturve viktime, duke garantuar që procesi penal, në çdo fazë të tij, të mos përkeqësojë traumën e përjetuar¹³⁰. Duhet të përmendet se me autoritet kompetent¹³¹, KDPM-ja përfshin të gjithë punonjësit të cilët vendosen në kontakt me fëmijën viktimë përfshirë gjyqtarin, prokurorin,

¹²⁸ Neni 2 (2), i Ligjit nr. 37/2017 “Kodi i drejtësisë penale për të mitur”.

¹²⁹ Neni 3 (3), Ibid.

¹³⁰ Neni 17 (2), Ibid.

¹³¹ Neni 3 (15), Ibid.

- punonjës in e policisë gjyqësore, punonjës in e policisë së shtetit, avokatin, psikologun, punonjës in social,, punonjës in e Njës isë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, etj.
- ii. **Neni 18 – Pjesëmarrja e detyrueshme e psikologut:** parashikon se në mënyrë që të mbrohen fëmijët nga trauma, prania e psikologut është e detyrueshme në të gjitha procedurat e ndjekjes penale (hetimi dhe gjykimi). Prania e psikologut është gjithashtu e nevojshme për të siguruar që intervistat me fëmijët të zhvillohen në mënyrën e duhur. Përveç kësaj parashikohet se kur është e mundur, i njëjti psikolog të ndjekë të njëjtin fëmijë viktimë përgjatë gjithë procesit. .
 - iii. **Neni 20 - Ndihma ligjore dhe psikologjike e të miturit (falas):** parashikon se në çdo fazë të drejtësisë penale për të mitur, çdo i mitur viktimë ka të drejtë për ndihmë ligjore dhe psikologjike, pa pagesë, të garantuar nga shteti, sipas legjislacionit përkatës.
 - iv. **Neni 21 – Mbrojtja e jetës private të të miturit:** parashikon se në çdo fazë të drejtësisë penale për të mitur privatësia e fëmijëve duhet të respektohet dhe çdo informacion që mund të çojë në identifikimin e fëmijës viktimë nuk lejohet të publikohet.
 - v. **Nenet 25-29-30-31-32 – mbi trajnimin dhe specializimin e autoriteteve kompetente:** parashikojnë se organet kompetente që punojnë me të miturit duhet të kenë ekspertizën e nevojshme¹³² dhe se personat që administrojnë procesin e drejtësisë penale për të mitur duhet të jenë të specializuar dhe të trajnuar në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve¹³³. Ky detyrim përfshin shumë punonjës dhe profesionistë të tillë si prokurorin, punonjës in e policisë gjyqësore, punonjës in e policisë së shtetit, avokatin, psikologun, punonjës in social, punonjës in e njës isë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, etj.
 - vi. **Neni 25 - Specializimi i personave që administrojnë dhe asistojnë procesin e drejtësisë penale për të mitur:** parashikon ndër të tjera, kufizime të personave që punojnë me të miturit dhe përkatësisht në paragrafin 2 përcakton se organet kompetente sigurojnë që çdo person që ka qenë i dënuar me një vendim të formës së prerë për një vepër penale të kryer me dashje ndaj të miturit ose për dhunë në familje, ndalohet të punojë me të miturin.
 - vii. **Neni 27 – Kompetenca e gjyqimit të çështjeve të drejtësisë për të miturit:** parashikon se brenda gjykatave të rretheve gjyqësore krijohen seksione të posaçme për çështjet e të miturve. Këto seksionet janë kompetente edhe për gjykimin e të pandehurve të rritur që akuzohen për kryerjen e veprave penale ndaj të miturve/fëmijëve .
 - viii. **Neni 37 – Masat mbrojtëse për të miturin viktimë ose dëshmitar:** parashikon se në çdo fazë të procesit penal duhet të merren masa të veçanta mbrojtëse për fëmijën viktimë kur siguria e fëmijës është në rrezik. Në varësi të rrethanave këto masa miratohen kryesisht nga gjyqtari (*ex-officio*), nga prokurori, nga policia gjyqësore ose Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës. Masat mbrojtëse konsistojnë në shmangien e kontaktit të drejtpërdrejtë midis të miturit viktimë dhe të akuzuarit, në çdo fazë të procesit; bërjen e kërkesës për nxjerrjen e një “urdhri-kufizimi” në gjykatë; bërjen e kërkesës për vendosjen e masës së sigurimit “arrest me burg” për të akuzuarin; mbrojtjen e fëmijës prej policisë; masa të tjera të përshtatshme.

¹³² Neni 25 (1), i KDMP-së.

¹³³ Neni 25 (4), Ibid.

- ix. **Neni 41 – Rregulla të veçanta të pyetjes së të miturit viktimë/dëshmitar e shfrytëzimit seksual ose dhunës seksuale seksuale:** parashikon këto rregulla të veçanta të zbatueshme për fëmijët viktimë të abuzimit seksual, të cilat i shtohen rregullave të tjera të intervistimit për fëmijët të parashikuara në nenet 39 dhe 40 të KDPM-së. Përkatësisht zbatohen këto rregulla: intervistat me fëmijët e abuzuar seksualisht kryhen detyrimisht me regjistrim audio dhe video; dëshmia në audio dhe video mund të shfaqet gjatë seancës gjyqësore; dëshmia e fëmijës mund të dëgjohet në sallën e gjyqit pa qenë i pranishëm ai/ajo, nëpërmjet përdorimit të teknologjive të komunikimit; ndalohet marrja në pyetje e fëmijës viktimë e abuzimit në familje në praninë e prindit ose të afërmit abuzues gjatë procedurës së vendosjes së urdhrat të mbrojtjes; gjyqet e abuzimit seksual të fëmijëve zhvillohen me dyer të mbyllura.
- x. **Neni 136 – Baza e të dhënave të drejtësisë penale për të mitur:** parashikon ngritjen e një baze të dhënash me qëllim krijimin e një sistemi i integruar i të dhënave për të mitur. baza e të dhënave do të përfshijë të dhëna mbi çdo fazë të procedimit penal që përfshijnë të miturit, pavarësisht nëse janë autorë, viktima apo dëshmitarë të veprave penale. Sistemi administrohet nga Ministria e Drejtësisë¹³⁴ dhe të gjithë zyrtarët që kanë një funksion gjatë procesit penal (prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore etj.) kanë të drejtë të kenë akses në sistem dhe të hedhin të dhënat që zotërojnë.

4.4. Kodi i Procedurës Penale

Përpara miratimit të KDPM-së, ishte kodi i procedurës penale i cili rregullonte disa aspekte të pozicionit të fëmijëve viktima në procesin penal. Sidoqoftë, këto dispozita ishin të kufizuara përse i përket përmbajtjes dhe shtrirjes së tyre dhe nuk ofronin shkallën e mbrojtjes që jepet tashmë nga KDPM-ja. Megjithatë, dy çështje të rëndësishme që ndikojnë në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve viktima të abuzimit seksual janë ende të rregulluara nga KPP-ja. Këto janë rregullat për fillimin dhe vazhdimin e ndjekjes penale në rastet e mungesës dhe/ose tërheqjes së ankimit nga viktima dhe rregullave për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave të gjendjes gjyqësore, gjë që është e rëndësishme në lidhje me kufizimet e vendosura për personat e përjashtuar nga puna në kontakt me fëmijët. Neni 24 (6) i KPP-së parashikon se ndjekja penale në Shqipëri mund të fillojë kryesisht (ex officio) nga Prokurori që do të thotë me iniciativën e Prokurorit kur nuk është i nevojshëm ankimi i/e të dëmtuarit. Rastet në të cilat ankimi i të dëmtuarit është i nevojshëm janë parashikuar në Nenin 284 (1) dhe përfshijnë ndër të tjera, veprat penale të parashikuara në nenet 105 dhe 106 të KP-së. Për këto çështje ndjekja penale mund të fillojë vetëm pasi i/e dëmtuara paraqet ankimin. Për më tepër, Neni 290 (1) (c) i KPP-së parashikon se në rastet kur ankimi është i nevojshëm për të filluar procedimin penal, tërheqja e ankimit nga i/e dëmtuari shkakton ndërprerjen e procedimit penal.

Përse i përket të dhënave të gjendjes gjyqësore, ekziston një regjistër gjyqësor ku depozitohen dhe përpunohen të dhënat lidhur me proceset penale të individëve. Ky regjistër parashikohet nga Nenet 481-484 i KPP-së dhe administrohet nga Ministria e Drejtësisë dhe mban të dhëna mbi dënimet e formës së prerë, vendimet në fazën e ekzekutimit, vendimet plotësuese, vendimet e

¹³⁴ Neni 137, Ibid.

pafajësisë dhe të pushimit të çështjes. Ajo që është e rëndësishme në kuadër të këtij shkrimi është Neni 484 (1) i cili parashikon se disa organe/ente kanë të drejtë të marrin vërtetimet e lëshuara nga ky regjistër mbi gjendjen gjyqësore të individëve. Këto janë organet e drejtësisë, organet e administratës publike dhe entet e ngarkuara me shërbime publike. Këto organe/ente mund të marrin vërtetimin e shënimeve të gjendjes gjyqësore për një person kur vërtetimi është i nevojshëm për kryerjen e funksioneve të personit. Pra regjistri është i dobishëm në rastin e kontrollit të punonjësve në kontakt të drejtpërdrejtë me fëmijët.

V. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Është e dukshme që gjatë vitit 2017 Shqipëria ka përmirësuar ndjeshëm legjislacionin e saj të brendshëm në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës. Ligji nr. 18/2017 dhe KDPM-ja janë një hap i rëndësishme në përafrimin e sistemit shqiptar të mbrojtjes së fëmijëve me standardet dhe parimet ndërkombëtare të përmendura më sipër. Megjithatë, rruga për të siguruar mbrojtjen efektive është e vështirë dhe shkon përtej miratimit të dispozitave ligjore. Legjislacioni i sapo miratuar është mjaft ambicioz dhe parashikon krijimin e një sërë strukturave dhe procedurave të reja . Këto struktura duhet të mbështeten nga vënia në dispozicion të burimeve të përshtatshme buxhetore dhe njerëzore për shërbimet sociale dhe gjyqësore për fëmijët e abuzuar seksualisht, elemente këto që kanë munguar gjatë viteve të kaluara.

Ndodh shpesh që Shqipëria të miratojë legjislacionin i cili është në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare - në mënyrë që të plotësojë në letër detyrimet e saj ndërkombëtare - por ky legjislacion në të vërtetë ka mangësi përse i përket procedurave administrative, burimeve njerëzore dhe strukturave ligj-zbatuese që bëjnë të mundur zbatimin e tij. Si rrjedhojë, ekziston një zhgënjim i përgjithshëm midis avokatëve dhe operatorëve të të drejtave të njeriut ndaj 'ligjeve të mira'. Në rastin konkret, për të bërë të mundur zbatimin efektiv të këtyre 'ligjeve të mira', duhet miratimi i një sërë akteve nën-ligjore. Këto akte ende nuk janë miratuar pavarësisht faktit se afati kohor prej 6 muajsh i caktuar për disa prej tyre tashmë ka kaluar. Sidoqoftë vetë ekzistenca e parimeve dhe procedurave të vendosura në ligjet e reja është një hap pozitiv përpara i cili na vë në dispozicion disa mjete të dobishme për t'i kërkuar shtetit shqiptar të zbatojë detyrimin e tij pozitiv për të mbrojtur fëmijët nga të gjitha llojet e abuzimit seksual. Pavarësisht nga komentet e përgjithshme të mësipërme, lind pyetja: *në ç'masë legjislacioni aktual shqiptar për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi seksual është në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar të analizuar më sipër? A ka mospërputhje dhe a kemi ende nevojë për përmirësime?*

Përsa i përket Ligjit nr. 18/2017 mund të thuhet në mënyrë të përgjithshme se ky ligj ka përvetësuar pothuajse të gjitha masat dhe parimet e vendosura nga Konventa e Lanzarotës dhe instrumentet ndërkombëtare të përmendura më sipër. Përfshihen masat ndihmëse dhe mbështetëse, masat e bashkërendimit, linjat ndihmëse të komunikimit (helplines), detyrimet e raportimit, masat e trajnimit dhe ndërgjegjësimit, masat kufizuese për personat që punojnë me fëmijët dhe masat mbrojtëse për fëmijët. Përsa i përket masave mbrojtëse Ligji 18/2017 ka veshur me përgjegjësi të konsiderueshme strukturat sociale brenda Bashkisë (njësitë e mbrojtjes së fëmijëve) të cilat vendosin mbi miratimin e masave mbrojtëse për fëmijët në rrezikuar. Të tilla masa mbrojtëse miratohen dhe zbatohen me vendimin e vet të strukturave të bashkisë, përpara se

të jepet një vendim gjykatë. Në këtë kuptim është pozitive që të ketë struktura të afta për të ndërhyrë dhe për të marrë vendime të rëndësishme për fëmijët përpara se çështja t'i të drejtohet gjykatës. Nga ana tjetër, kjo vendimmarrje është shumë delikate dhe duhet t'u besohet vetëm punonjësve socialë të mirë specializuar dhe të trajnuar, të cilët vërtet janë në gjendje të identifikojnë rëndësinë e rrethanave dhe të marrin vendimin e duhur duke pasur parasysh dhe interesat e larta në lojë. Gjithashtu, Njësive të Mbrojtjes së Fëmijëve brenda Bashkive dhe ASHDMF-ve duhet t'u vihen në dispozicion burimet e nevojshme buxhetore dhe njerëzore me qëllim që të gjitha strukturat të funksionojnë në mënyrë efektive.

Përsa i përket KDPM-së mund të arrihet në përfundimin se ai përmban parimet dhe standardet ndërkombëtare të kërkuara për trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me fëmijët viktime të abuzimit, përfshirë abuzimin seksual. Si rezultat, miratimi i KDPM-së është një hap i mirëpritur përpara. Megjithatë duke pasur parasysh procesin sfidues të ndërtimit të një sistemi të ri penal të drejtësisë për të mitur, rekomandohet që të gjitha institucionet e përfshira të aktivizohen me qëllim që ta ngrenë këtë sistem dhe ta bëjnë atë efektiv duke vendosur në dispozicion burimet e nevojshme financiare dhe njerëzore dhe duke miratuar aktet nënligjore zbatuese.

Përsa i përket KP-së mund të arrihet në përfundimin e përgjithshëm se, pas përmirësimit të legjislacionit shqiptar nëpërmjet miratimit të legjislacionit të ri, pjesa më e dobët e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri mbetet KP-ja . Kjo sepse veprat penale që lidhen me abuzimin seksual të fëmijëve nuk janë të formuluar në përputhje me kërkesat ndërkombëtare. Së pari duhet të theksohet se kodi penal shqiptar bën një dallim të pakuptueshëm midis abuzimit seksual dhe homoseksual. Dallimi konsiston vetëm në identifikimin e këtyre abuzimeve si të dy formave të ndryshme dhe jo në shkallën e dënimit që është e njëjtë për të dyja. Pavarësisht faktit se pjesa e KP-së ku përfshihet neni i abuzimit seksual dhe homoseksual të fëmijëve është ndryshuar në vitin 2013, ligjvënësi nuk e ka ndryshuar këtë dallim duke ruajtur këtë dispozitë diskriminuese të gdhendur në kodin penal. Ky fakt është vënë gjithashtu në dukje nga Komiteti i Lanzarotë-s në raportin e tij të parë zbatues të vitit 2015¹³⁵, i cili ka pohuar se vetë fakti që KP-ja bën dallimin midis abuzimit seksual dhe abuzimit homoseksual si dy vepra penale të ndryshme është stigmatizuese. Prandaj është e rekomandueshme që të gjitha nenet e KP-së që përmbajnë këtë dallim të ndryshohen menjëherë. Së dyti dispozitat materiale të KP-së në lidhje me abuzimin seksual të fëmijëve nuk janë të plota, nuk kanë shtrirjen e kërkuar nga instrumentet ndërkombëtare dhe parashikohen në mënyrë të çorganizuar gjë që mund të krijojë konfuzion. Neni i vetëm që është në përputhje me Konventën e Lanzarotë-s dhe me kërkesat e Direktivës 2011/92/EU është Neni 100 i KP-së i cili dënon marrëdhëniet seksuale me të miturit që nuk kanë arritur moshën 14 vjeç. Për më tepër ai shkon përtej kërkesave ndërkombëtare duke siguruar që është i dënueshëm edhe aktiviteti seksual me të miturin i cili nuk ka arritur pjekurinë seksuale, pavarësisht nga moshja. Megjithatë, nga formulimi i nenet është e kuptueshme që kjo shtirje është e zbatueshme vetëm për fëmijët e seksit femër, gjë që përbën sërish një diskriminim të tipit të sipërpërmendur i cili duhet të shfuqizohet menjëherë.

¹³⁵ Komiteti i Lanzarotë-s, 1st Raporti i zbatimit, "Protection of children against sexual abuse in the circle of trust: The framework", fq.15.

Veprimtaritë seksuale kundër fëmijëve nëpërmjet shpërdorimit të pozitës së besimit, autoritetit apo ndikimit nuk janë të rregulluara shprehimisht. Ekziston Neni 106 i KP-së i cili dënon marrëdhëniet seksuale ndërmjet personave të lidhur të tillë si prindërit dhe fëmijët, vëllezërit dhe motrat, ose prindërit birësues dhe kujdestarët. Sidoqoftë, ky nen duket më shumë i orientuar në parandalimin e marrëdhënieve seksuale mes anëtarëve të familjes (incestit), qoftë kjo familja biologjike apo jo-biologjike, sesa në mbrojtjen e fëmijëve nga abuzuesit tek të cilët ata besojnë, nga të cilët janë të ndikuar ose të cilët ushtrojnë autoritetin e tyre mbi fëmijët. Për më tepër, edhe pse ky nen mund të përdoret, në formulimin ekzistues, për të ndëshkuar abuzimin seksual të prindërve dhe kujdestarëve ndaj fëmijëve, ai lë jashtë fushës së veprimit të tij një gamë të gjerë personash të tjerë të cilët për shkak të pozicionit të tyre mund të abuzojnë me autoritetin që kanë mbi fëmijët ose të ushtrojnë ndikim të padrejtë mbi ta siç janë mësuesit; të afërmit e familjes; miqtë e familjes; fqinjët dhe persona të ngjashëm. Ky grup personash konsiderohen si 'rrethi i besimit' dhe shtrihet përtej kategorive të renditura në Nenin 106. Si rrjedhojë rekomandohet që një dispozitë e tillë specifike të shtohet në kodin penal dhe të formulohet siç parashikohet në Konventën e Lanzarotë-s.

Marrëdhëniet seksuale kundër fëmijëve nëpërmjet shtrëngimit, forcës ose kërcënimeve nuk janë plotësisht të rregulluara. Neni 101 dënon abuzimin seksual me dhunë kundër të miturve në moshën 14-18 vjeç. Nuk përmend shtrëngimet ose kërcënimet siç kërkohet nga Konventa e Lanzarotë-s. Si rrjedhojë, dispozita shqiptare ngushton numrin e sjelljeve penale të dënueshme nga Nenin 101 ndaj duhet të ndryshohet duke përfshirë kërcënimin dhe shtrëngimin në formulimin e këtij neni.

Veprimtaritë seksuale kundër fëmijëve nëpërmjet abuzimit të një situate veçanërisht delikate të fëmijës, siç është aftësia e kufizuar mendore ose fizike ose një situatë varësie, nuk është e rregulluar plotësisht. Neni 103 parashikon veprën penale të për abuzimit seksual kundër personave të pazotë për t'u mbrojtur. Ai zbatohet në përgjithësi për personat me aftësi të kufizuara fizike ose mendore, pa kufij moshe. Të qenurit fëmijë nuk përbën një rrethanë të veçantë rënduese. Përveç kësaj, situata e varësisë, siç kërkohet nga Konventa Lanzarotë-s, as nuk përmendet. Si rrjedhojë duhet të miratohet një nen i veçantë që dënon abuzimin seksual ndaj fëmijëve të gjendur në këto rrethana të brishta ose të parashikohet ky lloj abuzimi ndaj fëmijëve si rrethanë rënduese të Nenin 103 të KP-së.

Një ndryshim tjetër i KP-së që konsiderohet i nevojshëm për të qenë në përputhje me kërkesat ndërkombëtare ka të bëjë me nenin 66 i cili rregullon parashkrimin e ndjekjes penale. Konventa e Lanzarotë-s në Nenin 33 të saj kërkon që parashkrimi i ndjekjes penale për çështjet e abuzimit seksual të fëmijëve duhet të jetë i mjaftueshëm që të lejojë viktimën të nisn proceset gjyqësore, pasi të kenë mbushur moshën madhore. Përmes interpretimit të përbashkët të nenin 66 KP-së me nenet specifike të abuzimit seksual të fëmijëve mund të llogaritet se afati i parashkrimit të ndjekjes penale për veprat penale kryesore është 10 vjet pas kryerjes së veprës penale (20 vjet kur zbatohen rrethana rënduese: dëmtime të rënda të fëmijës, vdekja, vetëvrasja etj.). Logjikisht, afati prej 10 vitesh është tepër i shkurtër që fëmijët të marrin veten nga përvoja traumatike dhe të marrin guximin për të denoncuar abuzimin, veçanërisht kur kjo ka ndodhur brenda rrethit të



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNAL.AL ♦ Numri 3

Shtator 2017

besimit. Duke marrë parasysh seriozitetin e veprave penale në fjalë, rekomandohet që këto lloj veprash penale të përjashtohen nga parashkrimi i ndjekjes penale, siç bëhet edhe për disa lloj vrasjesh. Duhet patur parasysh se abuzimi seksual dëmton jo vetëm fëmijën e së tashmes, por edhe të rriturin e së ardhmes duke shkaktuar kështu një dëm të madh për individin dhe shoqërinë në tërësi. Si opsion, siç kërkohet nga Konventa e Lanzarotë-s, afati i parashkrimit të ndjekjes penale duhet të lidhet me mbushjen e moshës madhore të fëmijës dhe duhet t'i garantohet viktimës një kohë e mjaftueshme. Së fundmi do të ishte e këshillueshme që të gjitha veprat penale që lidhen me abuzimin seksual të fëmijëve të rregullohen në mënyrë të harmonizuar dhe të koordinuar në një pjesë të veçantë të kodit penal shqiptar, me anë të dispozitave të formuluarat qartë dhe jo-diskriminuese të cilat të përfshijnë të gjitha llojet e sjelljeve seksuale që mund dëmtojnë fëmijët, të paktën të gjitha ato sjellje që tashmë janë të parashikuara në konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria.

Përsa i përket dispozitave të KPP-së është i nevojshëm ndryshimi i Nenit 284 (1) në lidhje me fillimin e procedimit penal. Konkretisht, Nenet 105 dhe 106 të KP-s duhet të hiqen nga lista e veprave penale për të cilat kërkohet ankimi i të dëmtuarit për fillimin e ndjekjes penale. Përsa i përket regjistrat gjyqësor të rregulluar nga Nenet 481-484 të KPP-së, një seksion i veçantë i tij duhet t'u kushtohet personave të dënuar për vepra penale që lidhen me abuzimin seksual të fëmijëve. Në këtë mënyrë do të krijohet një bazë më e plotë dhe e organizuar e të dhënave që do të lehtësonte punën e autoriteteve gjatë kontrollimit të integritetit të personave që punojnë me fëmijët. Për më tepër që kjo është një kërkesë e Konventës së Lanzarotë-s e cila parashikon jo vetëm mbledhjen e të dhënave të lidhura me identitetin e abuzuesit seksual por gjithashtu dhe mbledhjen e profilit të tyre gjenetik (ADN)¹³⁶. Deri më tani nuk ka asnjë gjurmë të ekzistencës së regjistrat të AND-së të personave të dënuar për abuzimin seksual të fëmijëve ose të planeve për të krijuar një regjistër të tillë në Shqipëri

¹³⁶ Neni 37 (1), Konventa e Lanzarotë-s.